

VENDIM

PANELI NR: 1

VENDIMI NR.: KPCC/D/A/52/2009
DATA E VENDIMIT: 19/8/2009

URDHËR

Në secilën prej 26 (njëzetë e gjashtë) kërkesave të përmendura në Listën e bashkëngjitur, Komisioni vendos që kërkesat të refuzohen.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke përshtatur dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") duke përshtatur dhe ndryshuar Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton UNMIK/REG/2006/50. Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë themeluar Agjencinë Kosovare të Pronës ("KPA") si agjenci të pavarur sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Kosovës, dhe kanë ndryshuar dispozitat përkatëse të UNMIK/REG/2006/50 dhe UNMIK/ADM/DIR/2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me kriteret e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Sipas nenit 22 të UNMIK/REG/2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e UNMIK/REG/2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079

3. Sipas Nenit 10-të të Ligjit Nr. 03/L-079, i cili ka ndryshuar nenin 7.1 të UNMIK/REG/2006/50, Komisioni për Kërkesa Pronësore ("Komisioni") duhet të emërohet nga Kuvendi me nominim nga Kryetari i Gjykatës Supreme, me kusht që deri në përfundim të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Statusin e Kosovës të datës 26 mars 2007, dy nga tre anëtarët, përfshirë Kryetarin, duhet të emërohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar. Dy anëtarët ndërkombëtarë të Komisionit janë emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar me vendimin e datës 6 mars 2009. Komisioneri vendor është emëruar me vendimin e Kuvendit të datës 12 mars 2009.

4. Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni konsideron se është i caktuar sipas rregullave dhe është kompetent të ushtrojë funksionin e vet sipas Ligjit Nr. 03/L-079, si dhe urdhëresave dhe legjislacionit relevant për zbatim.

ARSYET PËR VENDIMIN

5. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshinë rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079.)

6. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të japë urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi I kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit I parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

7. Komisioni ka mbajtur seancën e tij të trembëdhjetë prej 17 deri 19 gusht 2009 në Prishtinë. Gjithsejt 1,036 kërkesa për pronë bujqësore i janë paraqitur Komisionit në seancën e tij të trembëdhjetë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës e ka njoftuar Komisionin që në 204 kërkesa pronat e kërkuara janë notifikuar fizikisht në mënyrë të gabuar. Komisioni ka pezulluar vendimarrjen mbi këto kërkesa duke i lënë në pritje që të ri-notifikohen nga Sekretaria Ekzekutive.

8. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat për pronësi

9. Në bazë të shqyrtimit të kërkesave dhe dokumentacionit mbështetës, informatave të ofruara dhe verifikimit të bërë nga Sekretaria Ekzekutive, tetë kërkesa i janë kthyer Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për shqyrtim dhe verifikim shtesë, ose janë tërhequr nga Sekretaria Ekzekutive. Gjithashtu, gjatë seancës një kërkesë për pronë bujqësore është ri-kategorizuar si kërkesë për pronë banesore.

10. Vendimi aktual përfshin 26 kërkesa për pronë bujqësore të regjistruara në Listën e bashkëngjitur. Në të gjitha këto kërkesa të përfshira në vendimin aktual paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë, dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë tokën bujqësore, kullosa dhe pyje. 797 kërkesa tjera, të cilat janë aprovuar nga Komisioni, janë përfshirë në vendimin KPCC/D/A/51/2009.

11. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin dhe që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund t'a ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni duhet të vërtetojë gjithashtu nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

12. Përderisa Komisioni ka marrë parasysh se humbja e posedimit që ka ndodhur jashtë periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, ai duhet të jetë i kënaqur se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë si pasojë e konfliktit.

13. Në Kërkesat Nr. 26370, 26371, 26372, 26373, 26374, 26375, 26378, 26379, 26380, 26381, 31212, 31213, 31219 dhe 31221, Paraqitësi i kërkesës, i cili ka paraqitur kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore, deklaroi që ai është larguar nga Kosova në vitin 1970 dhe ka shkuar në Serbi, dhe që nga ajo kohë ai ka vazhduar të shfrytëzojë pronat e tij.

Ai thekson se nuk është zhvendosur për shkak të konfliktit dhe asnjëherë nuk e ka humbur posedimin e pronave të tij. Ai ka paraqitur kërkesën e tij për të konfirmuar të drejtën e tij pronësore dhe të sigurojë mbrojtje ligjore për të drejtën e tij.

14. Në Kërkesat Nr. 41153, 41155, 41156, 41157, 41158, 41160, 42189, 42190, 42191, 42192 dhe 42193, Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar babain e Paraqitësit të kërkesës si bartës të së drejtës pronësore përmes arkivave kadastrale të zhvendosura në Serbi. Rrjedhimisht Komisioni është i mendimit që Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të familjes të bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës i ka konfirmuar Sekretarisë Ekzekutive që ai nuk është zhvendosur për shkak të konfliktit në Kosovë dhe asnjëherë nuk e ka humbur posedimin e pronave së babait të tij. Ai deklaroi se është larguar nga Kosova në vitin 2002 për shkak të situatës së vështirë dhe mungesës së mundësive në fshatë, nuk ka qenë i detyruar të largohet nga fshati dhe mund të kthehet në pronat e kërkuara pa asnjë problem në çdo kohë. Në ndërkohë i ka dhënë leje nipit të tij të shfrytëzoj pronat. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ka paraqitur kërkesën për të marr konfirmimin për të drejtën e tij ligjore mbi pronat.

15. Në Kërkesën Nr. 07942, Paraqitësi i kërkesës ka pranuar se e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar si rezultat i kontestit familjar në vitin apo rreth vitit 1992. Komisioni më herët kishte refuzuar një numër kërkesash tjera të paraqitura nga Paraqitësi i njëjtë i kërkesës bazuar në atë që nuk ndërlidhen me konfliktin e viteve 1998-1999 (shih vendimet e Komisionit KPCC/D/A/17/2008 të datës 30 prill 2008 dhe KPCC/D/A/30/1998 të datës 19 dhjetor 2008).


16. Nuk ka asnjë dëshmi në dispozicion të Komisionit që tregon se në ndonjërin nga kërkesat e përmendura në paragrafët 13, 14 dhe 15 të mësipërm, paraqitësit e kërkesave apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, janë zhvendosur nga prona e kërkuar, ose kanë humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, përkohësisht ose në ndonjë mënyrë tjetër, si pasojë e konfliktit. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se këto kërkesa qëndrojnë të refuzohen dhe urdhri të jepet siç është dhënë më sipër. Vendimi i Komisionit është pa paragjykim ndaj të drejtës së paraqitësve të kërkesave apo bartësve të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, për të kërkuar konfirmimin e të drejtës së tyre pronësore mbi pronat e kërkuara para autoriteteve lokale kompetente, në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

B. Kërkesat për kompensim

17. Në kërkesat e përmendura në kolonat përkatëse të Listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave, përveç pronësisë gjithashtu kërkojnë kompensim për dëmin material, apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka jurisdiksion mbi kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, edhe këto kërkesa qëndrojnë të refuzohen.

C. Vërejtje përmbledhëse

18. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i madh. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA07942	KPA26370	KPA26371	KPA26372	KPA26373	KPA26374	KPA26375
KPA26378	KPA26379	KPA26380	KPA26381	KPA31212	KPA31213	KPA31219
KPA41153	KPA41155	KPA41156	KPA41157	KPA41158	KPA41160	KPA31221
KPA42189	KPA42190	KPA42191	KPA42192	KPA42193		